REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 111/17
Date/Datum. 22.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 111/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina- Kryetar, z. Goran Milenković - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NTG"Blendi"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material për shtyp" me nr. prok. 701/16/109/121, iniciuar nga AK-/Qendra Klinike Universitare e Kosovës/ më datën 16.05.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Hedhet poshtë**, si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik NTG"Blendi"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për shtyp" me nr. prok. 701/16/109/121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Qendra Klinike Universitare e Kosovës /.

II. **Vërtetohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së / Qendra Klinike Universitare e Kosovës /, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me material për shtyp" me nr. prok. 701/16/109/121.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTG"Blendi"- Prishtinë, hedhet poshtë si e pa lejuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:16.08.2016
Hapja e ofertave është bërë me dt:07.09.2016, ku kanë marr pjesë dymbëdhjetë operator ekonomik.
Njoftimi i fundit për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:29.03.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Office Kosova SHPK"- Prizren.
Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik NTG"Blendi"- Prishtinë me dt: 01.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.
Me dt: 05.04.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, NTG"Blendi"- Prishtinë
Operatori ekonomik ankues "NTG Blendi"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14 Prill 2017 me nr. 111/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për shtyp" me nr. prok. 701/16/109/121, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Qendra Klinike Universitare e Kosovës" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- *Neni 7 i LPP (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi),*
- *Neni 59 i LPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve),*
- *Neni 60 i LPP (Kriteret për Dhënien e Kontratës),*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 25.04.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 05.05.2017, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës" për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material për shtyp" me nr. të Prokurimit: 701-16-109-121, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues

që të anuloj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**, ndërsa ankesa e OE ankues te aprovohen si pjesërisht te bazuar.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 10.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 09.03.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16. 05. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertja e OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Blendi" z.Rama deklaroj: Lidhur me ekspertizën 111/17 për aktivitetin furnizim me material për shtyp, qëndrojmë pranë konstatimit dhe pajtohemi me mendimin e ekspertes se nuk janë respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së nga ana e AK-së, për të shpallur fitues Office Kosova, pasi nuk i ka plotësuar gjitha kërkesat e dosjes, mirëpo shfaqim kundërshtim për eliminimin e kompanisë tonë me konstatimin se nuk kemi plotësuar si duhet formularin e tenderit. Formulari tenderit është nënshkruar dhe plotësuar si duhet, sepse pjesa e pa plotësuar ku thuhet shëno emrin e AK dhe titullin e kontratës është pjesë që e plotëson AK në shumtën e rasteve, dhe në rastin e ofertës tonë janë të plotësuar me header te formulari i tenderit, numri i prokurimit 701/16/109/121 dhe titulli furnizim me material për shtyp. Pra dihet qartë se i terë tenderi i është drejtuar QKU-së për aktivitetin që kemi ofruar.

Mos plotësimi i këtij titulli që është lëshim teknik nuk qon fare peshë dhe është devijim i vogël që nuk e ndryshon dhe dëmton aktivitetin e prokurimit dhe është thjesht devijim jo material që pranohet dh lejohet me nenin 59.4 të LPP-së.

Sa i përket arsyetimit të dhënë nga AK se kemi shkel nenin 130 të LPP-së kinse kemi bashkëpunuar me OE Grafoloni, OE Nord, dh e OE Blendi, për konkurim, kjo nuk qëndron fare dhe është paragjykim i qëllimshëm për të na eliminuar dhe për të shpallur fitues Office Kosova, me çka edhe eksperti shqyrtues ka konstatuar se nuk ka has argument për këtë çështje.
Ne gjatë qasjes në dokumente, kemi marr të gjitha dokumentet nga AK dhe pas shikimit të dokumenteve kemi vërejt se Office Kosova nuk e ka deklaratën për specifikacioni teknik, si dhe nuk plotëson kriterin për tri referenca me kontrata për periudhën e cekur në FDT. Për këtë arsye OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm. Andaj kërkojmë nga paneli shqyrtues të OSHP-së të aprovoj ankesën tonë, të marr vendim për anulim të vendimi për dhënie të kontratës, dhe tenderi

jonë të shpallet i përgjegjshëm dhe aktiviteti i prokurimit tender për furnizim me material për shtyp të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi të AK-QKUK z. Cenaj deklaroj: Në emër të AK-së më duhet të kundërshtoj raportin e ekspertit shqyrtues. Para këtij vendimi ekziston një vendim i mëhershëm e i OSHP nr. 19-21/17, që duhet respektuar si AK. Duhet të citoj në atë vendim thuhet "lidhur me pretendimin e OE ankues Blendi se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofrua tri referenca të natyrës së njëjtë të furnizimeve gjatë tri viteve të fundit, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar referenca që mjaftueshëm dëshmojnë se ky OE ka përmbushur substancialisht kërkesën lidhur me referencat, pasi që në kontrata dhe referenca që ka ofruar ky OE shihet qarrtë se furnizimet që ka bërë janë të natyrës së njëjtë pa marr parasysh emërtimin e kontratës.

Në funksion të respektimit të këtij vendimi AK konkretisht komisioni rivlerësues ka kërkuar nga OE Office Kosova konform letrës standarde të kërkesës për sqarim të tenderit, të sillen referenca në lëmin e shtypit për kontratat nga lista e prezantuar në ofertë. Ekziston edhe baza ligjore për këtë kërkesë, neni 39 i UOPP-së, sqarimi tenderëve ka specifikuar kur mund të kërkohen referenca shtesë. Ne kemi bërë kërkesë për ofrim të referencës nga lista e projekteve e cila veç ka ekzistuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Pikë tjetër është deklarata për specifika teknike, nëse i referohemi sqarimit të tenderit që ka dhënë KRPP dhe kam qenë vet kontribut dhënës në këtë udhëzues, thuhet "deklarata për specifikacione teknike kërkohet në rastet kur kërkon ndonjë pajisje ku kërkohet plus katalogu".

Është kërkesë e nenit 69 të LPP-së. Edhe sikur të ishte në njoftim për kontratë (edhe pse në rastin konkret nuk ka qenë), deklarata për specifika teknike nuk ka qenë në njoftim për kontratë. Ne kemi kërkuar formular A4, andaj nuk ka pas në kërkesa specifikacione.

KRPP ka nxjerr rregullore për parashtrim të ankesave, nëse i referohemi rregullores që është pjesë e LPP-së, formulari F03 neni 9 thotë "ankesa do dorëzohet në origjinal në OSHP dhe njëkohësisht një kopje ankesës do i dërgohet AK-së. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në AK". Pretendimi i OE ankues deklarata në specifika teknike në ankesën e dorëzuar në OSHP, nuk ka qenë pjesë e ankesës së dorëzuar pranë AK-së.

Po ashtu kjo rregullore e saktëson UOPP, se nëse formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet duet refuzuar tenderin, si i tillë ankuesi është i papërgjegjshëm, dhe me që është i papërgjegjshëm neni 4 e ka saktësuar se "palë e interesuar" është personi që mund të dëshmoj interes material nga aktiviteti, në rastin konkret përveç që nuk qëndrojnë pretendimet , OE i rekomanduar është i përgjegjshëm dhe ankesa e OE ankues duhet mos marr parasysh pasi ky OE është palë pa interes.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese deklaroj: I rekomandoj panelit shqyrtues të anuloj vendimin e AK-së dhe njoftimin për dhënie dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj z.Rama deklaroj: Ne kemi pas qasje në dokumente dhe me gjithë faktin se AK ka bërë kërkesë te OE i rekomanduar për kontratë, me gjithë plotësimin e dokumenteve OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat e dosjes së AK-së. Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve tona ankimore dhe i rekomandojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z. Cenaj deklaroj: Kërkojmë nga paneli të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të lejohet AK të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme.

Përfaqësuesi i OE të rekomanduar për kontratë "Office Kosova" z.Gigollaj deklaroj: E lusim panelin shqyrtues të OSHP-së që të trajtoj këtë ankesë dhe lëndën në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP-së.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 05.05.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka vepruar konform vendimit të panelit shqyrtues me nr.19,21/17 të dt:07.03.2017, përkitazi me operatori i ekonomik i rekomanduar për kontratë "Office Kosova", pasi që në vendimin lartpërmendur është konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë "Office Kosova" e ka përmbushur kërkesën në lidhje me tri referenca të natyrës së njëjtë për tri vitet e fundit duke e përmbushur substancialisht këtë kërkesë pasi që kontratat dhe referencat e ofruara nga ky OE janë të natyrës së njëjtë pa marr parasysh emërtimin e tyre.
Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën e specifikacionit teknik për mallrat e ofruara, paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk është parashtruar nga ana e OE ankues me kërkesën për rishqyrtim dhe natyrisht që ky pretendim nuk mund të shqyrtohet nga OSHP-ja, pasi që nuk ka pasur një shqyrtim paraprak nga ana e autoritetit kontraktues. Këtë e parasheh neni 9.2 i Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave ku shkruan që "*Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues".Prandaj pretendimet e paraqitura në OSHP, e të cilat nuk janë të njëjta me pretendimet e paraqitura tek autoriteti kontraktues nuk mund të shqyrtohen.*

Paneli shqyrtues konstaton se është e qëndrueshme arsyeja e eliminimit të operatorit ekonomik ankues "Ntg Blendi", pasi që ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar pjesën I të formularit të tenderit duke e lënë të zbrazët rubrikën ku është dashur të shënohet emri dhe adresa e autoritetit kontraktues, prandaj plotësimi i dosjes së tenderit-formularit të tenderit nuk është bërë sipas nenit 18 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ Për prokurim Publik.

Duke pasur parasysh faktin se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuat të gjitha kërkesat dhe kriteret e autoritetit kontraktues, ndërsa operatori ekonomik ankues ka ofruar tender me çmim më të lartë se OE i rekomanduar dhe njëkohësisht është i papërgjegjshëm, prandaj rezulton se OE ankues "Ntg Blendi" në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Qendra Klinike Universitare e Kosovës"

1x1 OE NTG"Blendi"-Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.